



## **Drejtori Ekzekutiv i AMSHC merr pjesë në takimin rajonal të Grupeve Këshillimore Lokale (LAG) të TACSO**

Beçici (Mal i Zi), 6 - 7 tetor 2015

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga TACSO, është edhe bashkëpunimi me Grupet Këshillimore Lokale (LAG), të cilat fillimisht kishin mision kontributin si organ këshillimor në nivel kombëtar, por që praktika tregoi se ky rol shkon përtej synimit fillestar.

Në këtë takim rajonal, i cili u organizua në Beçici, Mal i Zi nga datat 6 deri në 7 Tetor 2015, morën pjesë përfaqësues nga Grupet Këshillimore Lokale si edhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, Bashkëpunimit Rajonal të Ballkanit Perëndimor dhe Njësia e Programeve.

Si një ndër pjesëmarrësit në këtë takim, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Andi Kananaj diskutoi në mënyrë të veçantë lidhur me rolin e rëndësishëm të misionit këshillimor të LAG si edhe përmirësimin e mundshëm të këtij misioni këshillimor.

Z. Andi Kananaj si edhe pjesëmarrësit në takim patën mundësinë të shkëmbenin mendime dhe të diskutonin konkretisht rreth çështjeve të mëposhtme:

1. Roli dhe kontributi i LAG lidhur me dinamikën e punës, përfitimet dhe sfidat;
2. Proceset e drejtuara nga TACSO në nivel rajonal dhe kombëtar mbi udhëzimet e BE në krijimin e këshillave të OJF-ve për programet e IPA;
3. Vizioni i rolit të LAG pas misionit të TACSO;

LAG realisht përveç shërbimit të këshillimit, mundëson ballafaqimin e target- grupeve kryesisht 3- palëshe duke mundësuar forume dialogu në funksion të diskutimeve rreth çështjeve që lidhen me Organizatat e Shoqërisë Civile në vend.

Përgjatë fazës së parë të TACSO (2009- 2013) janë realizuar dy takime me përfaqësues të LAG nga të gjitha vendet e TACSO, të cilat rezultuan së ishshumë të dobishme.

Gjatë kësaj faze të parë të projektit të financuar nga Bashkimi Europian ( BE) – Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile ( TACSO), përfaqësues nga Grupi Këshillimor Lokal ( LAG), BE dhe TACSO janë takuar dhe kanë diskutuar rreth çështjeve të ndryshme që lidhen me perspektivën dhe synimet e së ardhmes të LAG dhe TACSO.

Takimi i organizuar në Malin e Zi ishte i pari i llojit të tij gjatë periudhës së fazës së dytë të TACSO.

Takimi synonte t'u jepte të gjithë pjesëmarrësve mundësinë e reflektimit rreth punës së LAG dhe TACSO si edhe shkëmbimin e pikëpamjeve, opinioneve, qëndrimeve dhe pritshmërive si edhe shkëmbimin e informacioneve me interes të përbashkët.

# "Java e Nënë Terezës, Java e Solidaritetit"

(12 - 18 tetor 2015)

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) së bashku me Bashkinë e Tiranës lançuan iniciativën "Javën e Solidaritetit dhe Vullnetarizmit" (12-18 Tetor) dedikuar Nënë Terezës dhe punës së saj.

Gjatë javës u përcaktuan disa pika grumbullimi, nga ku u mbledhën ndihma për familjet në nevojë ose me ndihmë sociale të identifikuara nga listat dhe programet e Bashkisë së Tiranës.

Gjithashtu, ditën e dielë, datë 18 Tetor, Bulevardi i Tiranës dhe sheshi përpara Bashkisë u kthye në zonë pedonale, për t'u përdorur nga Shoqatat dhe Fondacionet për të promovuar punën e tyre në formë panairi.

## Takim me Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj

Tiranë, 15 tetor 2015

Në kuadër të aktiviteteve të javës së Nënë Terezës, më 15 tetor 2015, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës organizuan një takim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe forumeve rinore si dhe grupeve të të rinjve vullnetarë.

Në këtë takim mori pjesë Kryetari i Bashkisë z. Erion Veliaj si dhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj.

Fjalën kryesore për të pranishmit e mbajti Kryetari i Bashkisë z. Erion Veliaj, i cili gjatë fjalës së tij nxori në pah virtytet dhe humanizmin e shenjtorese sonë Nënë Tereza, e cila gjithë jetën e saj ia kushtoi ndihmës ndaj shtresave të varfra, në nevojë të ushqimit dhe shëndetsisë, në mbarë globin.

Kryetari i Bashkisë, z. Veliaj ftoi të rinjtë vullnetarë si dhe gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile që të angazhohen në një fushatë për grumbullimin e ndihmave për familjet në nevojë pasi vetëm kështu mund të kontribuojmë në bërjen realitet të ëndrrës së Nënë Terezës, ndihmën dhe përkushtimin ndaj të varfërve dhe grupeve të tjera vulnerabël.

Gjithashtu, në këtë takim foli dhe z. Ened Mato, i cili bëri një ekspozë të planit të aktiviteteve të kësaj jave si dhe ftoi vullnetarët t'u bashkëngjiten aktorëve të tjerë të shoqërisë civile pranë pikave të grumbullimit, për t'i mbajtur funksionale këto pika deri në orët e vona, pasi fluksi i atyre që duan të dhurojnë ndihmat e tyre për shtresat në nevojë është i madh.

Të gjithë pjesëmarrësit shprehen gadishmërinë e tyre ndaj kësaj nisme dhe kjo u duk që në momentin e mbylljes së takimit, të cilët kërkuan të regjistrojnë emrat e tyre për të marrë në patronazh të gjitha pikat e grumbullimit.

AMSHC dhe përfaqësues nga Bashkia falënderuan pjesëmarrësit dhe premtuan për vazhdimësinë e kësaj nisme përtej javës së Nënë Terezës, në të ardhmen.







## Panairi i Organizatave të Shoqërisë Civile

Tiranë, 18 tetor 2015

Në vijim të aktiviteteve të "Javës së Nënë Terezës", më 18 tetor 2015, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës organizuan në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", panairin e organizatave të shoqërisë civile.

Në këtë panair morën pjesë një numër i konsiderueshëm i organizatave të shoqërisë civile, të cilat sollën për publikun e gjerë, nëpërmjet fletëpalosjeve, posterave, broshurave dhe materialeve të tjera promovuese, gjithë suksesin e punës së tyre.

Në panair nuk mungoi edhe promovimi i punës dhe suksesit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) nëpërmjet shpërndarjes së dosjeve me materiale promovuese si dhe stilolapsave me logon e AMSHC-së.

Përveç publikut të gjerë, panairin e nderoi me pjesëmarrjen e tij dhe Kryetari i Bashkisë, z. Erion Veliaj së bashku me bashkëshorten, i cili vlerësoi punën e bërë nga Organizatat e Shoqërisë Civile dhe i falënderoi ata si dhe premtoi se do të ketë edhe më tepër organizime të tilla në të ardhmen.

AMSHC dhe përfaqësues nga Bashkia falënderuan pjesëmarrësit dhe prematuan për vazhdimësinë e kësaj nisme përtej "Javës së Nënë Terezës", në të ardhmen.









## USAID nxjerr Indeks 2014: AMSHC intensive me OShC-të dhe gjithë aktorët ndërkombëtarë që veprojnë në këtë fushë

Tiranë, 16 tetor 2015

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), ka prezantuar edicionin e tetëmbëdhjetë të Indeksit rreth Qëndrueshmërisë së OShC-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe Euroazinë, për vitin 2014.

Në këtë Indeks analizohen dhe përcaktohen rezultatet për shtatë dimensione të shoqërisë civile, të ndërlidhura me njëra tjetrën të tilla si: mjedisi ligjor, kapacitetet organizative, qëndrueshmëria financiare, advokimi, ofrimin e shërbimeve, infrastruktura dhe imazhit publik.

Indeksi nxjerr në pah përparimet dhe pengesa për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile, dhe bën krahasime ndërmjet vendeve të rajonit dhe më gjerë duke theksuar se në vitin 2014, qëndrueshmëria financiare e OShC-ve nuk është përmirësuar.

Në Indeks, ndër të tjera analizohet dhe puna e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ku theksohet se AMSHC është burimi kryesor i financimit të qeverisë për sektorin në fjalë dhe se gjatë vitit 2014, Agjencia ka lëshuar dy thirrje për propozime, ku ka dhënë gjashtëdhjetë e tre grande, me një shumë që varjon nga 500.000 lekë (afërsisht 3,500 €) deri në 5.000.000 lekë (afërsisht € 35,000).

Thuhet gjithashtu, se një nga prioritetet e thirrjeve ka qenë mbështetja për rritjen e kapaciteteve advokuese të OShC-ve për t'u angazhuar në hartimin e politikave, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin, ndërtimin e institucioneve, komunikimin publik, si dhe në angazhimin e qytetarëve. Në të njëjtën kohë, në Indeks, duke ju referuar dhe një raporti hulumtues nga Balkan Insight, thuhet se gjatë vitit 2014, ka pasur dyshime në lidhje me mënyrën në të cilën Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile merr vendime për financim me grande.

Sa i përket infrastrukturës mbështetëse për shoqërinë civile gjatë vitit 2014, në Indeks theksohet se ajo është përmirësuar ndjeshëm, se gjatë vitit 2014 është zgjedhur një Bord i ri Mbikëqyrës i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) si dhe është diskutuar me OShC-të në nivel lokal përmes një procesi konsultativ një strategji afatmesme.



AMSHC, gjithashtu, ka bashkëpunuar në mënyrë intensive me OShC-të dhe gjithë aktorët ndërkombëtarë që veprojnë në këtë fushë, por ajo ende ka nevojë të reformojë menaxhimin e saj të brendshëm dhe financiar, për të qene në gjendje që të shërbejë si një institucion mbështetës kryesor për shoqërinë civile.

Gjithashtu, në Indeks theksohet se në dhjetor 2014, Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, miratoi Rezolutën për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në proceset demokratike, e cila synon të mbështesë iniciativat ligjore për një mjedis të përshtatshëm për OShC-të dhe të rrisë më tej bashkëpunimin e OShC-ve me AMSHC-në.

## Konferenca e 24-t vjetore e VOLONTEUROPE

Sevilje (Spanjë), 28 - 30 tetor 2015



Nga data 28 deri më 30 tetor 2015, tre përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), konkretisht Kryetari i Bordit Mbikëqyrës, z. Adrian Thano, një prej anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së dhe anëtar i Bordit të VOLONTEUROPE, z. Ismail Ademi, si dhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj, morën pjesë në Konferencën Vjetore të 24-t të VOLONTEUROPE, e organizuar në partneritet me unionin spanjoll "Alianza por la Solidaridad", në Sevilje, Spanjë.

Kjo konferencë u organizua në kuadër të Vitit Evropian për Zhvillim (EYD2015) dhe u fokusua në rolin e shoqërisë civile në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe drejtësinë globale.

Të gjithë pjesëmarrësit patën mundësi të dëgjonin gjatë fjalimeve të tyre kryesisht nga ekspertët në terren si dhe nga debatet në panele. Ata gjithashtu patën mundësi të vizitonin OJF-të lokale dhe të merrnin pjesë në tryeza të rrumbullakëta me tema:

- Biznes i Përgjegjshëm
- Mobilizimi i të rinjve
- Demokraci Pjesëmarrëse dhe Drejtësi Sociale në nivel lokal
- Bashkëpunim për Zhvillim Evropian

Gjatë konferencës u organizua dhe edicioni i 9 i dhënies së çmimeve me temë "Qytetarët aktivë të Evropës", të cilat iu dhanë individëve dhe kolektivave që kishin dhënë kontribut të shquar për një zhvillim të qëndrueshëm dhe drejtësi globale.

Prej 10 vitesh, Volonteurope, në bashkëpunim dhe financim nga Komisioni Evropian, jep çmimin Active Citizens of Europe, i cili vlerëson kontributet e paçmueshme të individëve, organizatave apo bizneseve në ndërtimin e një shoqërie aktive, qytetare që përqipet në përmirësimin e jetës së komunitetit.

Për 2015-ën, në kategorinë e bizneseve më një vëmendje sociale të theksuar, pas propozimit të AMSHC-së, çmimi i shkoi Altin Prengës, titullar i Agriturizmit "Mrizi i Zanave", i cili është shndërruar në motor zhvillimi për gjithë zonën e tij rurale.

Me këtë çmim vlerësohet eksperiencia dhe sakrificat e Altinit dhe i hapet rrugë diskutimit rreth rëndësisë së sipërmarrjeve sociale dhe rolin që organizatat e shoqërisë civile duhet të luajnë në këtë proces.

Në mbyllje të saj, Konferenca nxorri një raport me temë "Mobilizimi i Qytetarëve për Drejtësi Globale", hartuar me kontributin e ekspertëve në terren, përfshirë Zyrën e Kryqit të Kuq të BE-së, Brigadat Ndërkombëtare të Paqes si dhe Platformën Sociale.





## AMSHC merr pjesë në një tryezë të rrumbullakët, organizuar nga Partnerë për Fëmijë

Tiranë, 30 tetor 2015

"Partnerë për Fëmijët" organizoi tryezën e rrumbullakët për prezantimin e dokumentit të politikës "Situata e Financimit nga Shteti të Organizatave të Shoqërisë Civile me qëllim Përmirësimin e Jetës dhe të të Drejtave të Fëmijëve dhe të të Rinjve në Shqipëri".

Në këtë takim, përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC); autoritete të qeverisë vendore; organizata të shoqërisë civile; të rinjtë si dhe përfaqësues të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) diskutuan ndër të tjera edhe për çështje që lidhen drejtpërsëdrejti qëndrueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë.

Kjo tryezë e rrumbullakët u organizua në kuadër të projektit "Kudri i Qëndrueshmërisë Financiare të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në katër rajone në Shqipëri" financiar përmes Fondit Ballkanik të Politikave Publike (BPPF) me mbështetje të Bashkimit Evropian dhe BTD, si pjesë e projektit "Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve" zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) si partner kryesor dhe IDM si partner zbatues në Shqipëri.





## Forumi “Pushteti vendor dhe vendimmarrja”

Durrës, 30 tetor 2015

Në kuadër të projektit: “Demokracia vendore si bashkëveprim i komunitetit qytetar me pushtetin lokal” të financuar nga AMSHC, Qendra e Studimeve “Shqipëria Europiane” organizoi në qytetin e Durrësit në sallën Odeon të Pallatit të Kulturës së këtij qyteti forumin: “Pushteti vendor dhe vendimmarrja”.

Projekti u realizua në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe me ndihmesën e posaçme të kryetarit të saj z. Vangjush Dako.

Të ftuarit në këtë forum ishin Kryetari i Bashkisë Durrës, z. Vangjush Dako; Prefekti i Qytetit, z. Roland Xhelilaj; pedagogu i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, z. Met Dervishi; gazetari, dramaturgu dhe shkrimtari, z. Bashkim Hoxha dhe i ftuar nga Tirana analisti i njohur dhe autori i disa librave me publicistikë, z. Andrea Stefani.



Forumit e drejtonte gazetari z. Ilir Yzeiri, që është njëkohësisht edhe drejtori i Qendrës “Shqipëria Europiane”.



Merrnin pjesë gjithashtu gazetarët e qytetit të Durrësit, dhe znj. Vali Qyrfyçi, Kryetare e Forumit të mediave të këtij qyteti dhe shoqata “Durrësi”.

Kryetari i Bashkisë z. Vangjush Dako theksoi se buxheti i Bashkisë do të vazhdojë të jetë jo në ato nivele që kërkon një qytet me mbi 200 mijë banorë si Durrësi, por ai përmendi aty disa nga financimet që do të realizohen me projekte të përbashkëta me donatorë të huaj dhe përsëriti sidomos angazhimin e tij dhe të forcës që ai përfaqëson për të ulur taksat.





## Konferenca Kombëtare - "Rrugëtimi i Gjellbër, Ta pastrojmë Shqipërinë në një Ditë"

Tiranë, 9 nëntor 2015

Sot në ambjentet e Qendrës Rinore të Tiranës, u zhvillua Konferenca Kombëtare me temë: "Rrugëtimi i Gjellbër, Ta pastrojmë Shqipërinë në një Ditë", në të cilën u lançua aksioni kombëtar i radhës për pastrimin vullnetar të mjedisit.

Fjalën e hapjes në këtë Konferencë e mbajti z. Ervin Shehaj, drejtuesi i Lëvizjes "Ta pastrojmë Shqipërinë".



Në këtë konferencë të organizuar nga Lëvizja Civile "Lëvizja Ta Pastrojmë Shqipërinë", morën pjesë përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Erion Banushi, Zv. Ministre e Arsimit dhe Sportit, znj. Nora Malaj, përfaqësuesja e Ministrisë së Mjedisit, znj. Ledina Karalliu, Drejtoresha e Shërbimit Kombëtar Rinor pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, znj. Ina Avllaj, drejtuesi i Lëvizjes Ecovolis, z. Ened Mato, kordinatori i Lidershipit të të Rinjëve të Tiranës, z. Kaludio Pulaha dhe koordinatori i Kryqit të Kuq Shqiptar, z. Armand Pambuku.

Përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Erion Banushi, foli mbi rolin e shoqërisë civile dhe sfidat e saj si dhe shprehu gatishmërinë e AMSHC-së për të mbështetur këtë nismë.



Në konferencë u fol mbi rolin e arsimit në edukimin mjedisor, Strategjinë për Rininë dhe Ligjin e Vullnetarizmit si edhe problematika të ndryshme dhe hapat e nevojshme që duhet të merren për përmirësimin e situatës, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e mëtjeshëm.

Në konferencë nuk munguan dhe diskutimet nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile mbi rolin e medias në informimin dhe adresimin e problematikave mjedisore, përfshirja e të rinjve në nisma vullnetare, kontributi në komunitet dhe aktivizimi mjedisor.

Të gjithë të pranishmit konfirmuan mbështetjen e tyre për realizimin me sukses të aksionit Ta Pastrojmë Shqipërinë - 20 Nëntor 2015.

Në fund konferenca u mbyll me thirrje për pjesëmarrje dhe bashkëpunim.



## Pjesëmarrje e AMSHC-së në forumin Erasmus+ "Youth in Action Forum for the Western Balkans"

Podgoricë (Mal i Zi), 16 - 19 nëntor 2015

Në datat 16 – 19 nëntor 2015, dy përfaqësues nga AMSHC, përkatësisht Drejtori Ekzekutiv, z. Andi Kananaj si edhe z. Erion Banushi, morën pjesë në Forumin Erasmus+ "Youth in Action Forum for the Western Balkans", zhvilluar në EU Info Center, në Podgoricë të Malit të Zi.

Gjatë ditëve të këtij Forumi tematikat e diskutuara përfshinin çështje të tilla si:

- Kuadri, Prioritete dhe Zhvillimet e Programit të Erasmus+ Youth in Action
- Sinergjitë midis Erasmus+ Youth in Action dhe iniciativave të tjera rajonale për të rinjtë
- Implementimi i procesit të Berlinit dhe iniciativave rajonale për të rinjtë etj.

Në përfundim të Forumit pati edhe një seancë reflektimi e shkëmbimi të eksperiencave të pjesëmarrësve në këtë Forum.

AMSHC dha kontributin e saj të veçantë lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programeve të Erasmus+ mbi vullnetarizmin në Shqipëri.

AMSHC parashtrori kërkesën për të qënë pjesë e këtij programi duke bërë edhe akreditimin në EVS (European Voluntary Service) si edhe shprehu interesin për të marrë pjesë në procesin e shkëmbimit të vullnetarëve në vend, rajon, por edhe më gjerë në Europë.

Me pjesëmarrjen në këtë forum, AMSHC pati mundësinë të ndërtojë lidhje të reja partneriteti me anëtarë të ndryshëm të programit të Erasmus+.



## Konferenca rajonale "Filantropia në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Investim për të ardhmen"

Beograd (Serbi), 24 - 26 nëntor 2015



Përfaqësuesi i AMSHC-së, z. Erion Banushi, mori pjesë në konferencën rajonale "Filantropia në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Investim për të ardhmen", e cila u organizua në Beograd, Serbi.

Në këtë konferencë u mbledhën përfaqësues të shoqërisë civile, të qeverisë dhe institucioneve publike, donatorë të ndryshëm, grupe interesi, media dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme që merren me çështje të filantropisë.

Konferencën e hapi përfaqësuesi i TACSO, i cili theksoi se kjo konferencë përbën ndryshimin, për shkak të pjesëmarrësve të ndryshëm, të cilët kanë kaq shumë për të ndarë me njëri-tjetrin nga eksperiencat e tyre.

Kjo konferencë synon të shqyrtojë rolin e Filantropisë në mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, modele për ndërtimin e

marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit, si të lidhë qëllimet dhe të ruajtur integritetin, si të zhvillojë dhe mbështesë një "imazh" që ngjall besim dhe mbështetje.

Gjatë këtyre ditëve, pjesëmarrësit në konferencë diskutuan çështje thelbësore që lidhen me filantropinë, statusin aktual të filantropisë, dhe dhanë rekomandime për të ardhmen.







## Event social "Chill & Chat"

Tiranë, 3 dhjetor 2015

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me Organizatën World Vision (Shqipëri dhe Kosovë), organizuan eventin social "Chill & Chat", në ambjentet e Qendrës "Tulla" në orën 19:00.

Në këtë event morën pjesë z. Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv i AMSHC-se; anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së; z. Stefano Calabretta, Drejtues i Projekteve për Shoqërinë Civile pranë Delegacionit të BE-së në Shqipëri, përfaqësues të tjerë të organizatave donatore dhe ndërkombëtare si edhe të shoqërisë civile, të cilat kanë në fokus të punës rininë.

Gjatë mbrëmjes, përfaqësues të shoqërisë civile paraqitën në formë galerie projekte lidhur me rininë.



## Seminar me temë "Krijimi dhe hartimi i një platforme mbi instrumentet e zhvillimit komunitar"

Kavajë, 14 dhjetor 2015



Sot më 14 dhjetor 2015, në qytetin e Kavajës, AMSHC e përfaqësuar nga znj. Mimoza Çorbaxhi, mori pjesë në seminarin me temë "Krijimi dhe hartimi i një platforme mbi instrumentet e zhvillimit komunitar", pjesë e projektit i cili po aplikohet nga "Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm" dhe i financuar nga AMSHC.

Në këtë seminar morën pjesë dhe përfaqësues të pushtetit lokal si dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile.

Prezantimi i vizionit dhe alternativave për instrumentet e zhvillimit komunitar u bë nga znj. Dorina Lulaj si dhe znj. Jona Kuci, përfaqësuese të "Qendrës për Zhvillim të Qëndrueshëm".

Më tej takimin e përhëndeti përfaqësuesja e AMSHC-së si dhe përfaqësuesja e pushtetit lokal duke theksuar rolin e madh që luan



shoqëria civile në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit si dhe në bashkëpunimin me pushtetin qendror dhe lokal.

Të gjithë pjesëmarrësit diskutuan rreth instrumenteve më të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm si punësimi, arsimimi, vullnetarizmi, bashkëpunimi me policinë, biznesi, portalet online, trashëgimia kulturore dhe diversiteti, asambleja rinore etj duke parashtruar mendimet e tyre se si të rritet performanca në të gjitha drejtimet.

Në fund të takimit organizatorët falënderuan pjesëmarrësit dhe shprehen gatishmëri për të qenë të hapur dhe mirëpritur çdo propozim që do të ndihmonte në përmirësimin e punës në të ardhmen.



## Panairi i OJF-ve dhe Ndërmarrjeve Sociale (Edicioni IV)

Shkodër, 16 dhjetor 2015



## Panairi i OJF-ve dhe Ndërmarrjeve Sociale

*- Edicioni i katërt -*

Në Shkodër, më datë 16 dhjetor 2015, u organizua edicioni i katërt i Panairit të OJF-ve dhe Ndërmarrjeve Sociale, si pjesë e eventit "Shkodra - n'Fest", që u zhvillua në pedonalen Kolë Idromeno.

Kjo iniciativë synon promovimin e një autonomie gjithmonë e më shumë në rritje të organizatave dhe shoqatave të angazhuara në fushën sociale, me qëllim që këto aktorë të njihen në mënyrë zyrtare në kuadrin e mirëqenies sociale. Për realizimin e këtij qëllimi vlerësohet në mënyrë të veçantë dhe kontributi pozitiv që organizatat e huaja dhe të diasporës mund t'i sjellin panoramës kombëtare, duke i dhënë jetë një shkëmbimi të frytshëm dhe të dyanshëm duke treguar rëndësinë e projekteve të zhvillimit.

Nëpërmjet këtij panairi, kërkohet të vihet në dukje rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të sektorit të tretë, duke e nxitur dhe duke i lënë hapësirë aftësisë së punës në rrjet, duke patur parasysh edhe interesin e shprehur nga ana e Bashkisë Shkodër

në programin e vet, si dhe brenda diskutimit të ditëve të sotme mbi nevojën për të krijuar një kuadër ligjor që të ketë si qëllim mbrojtjen e shoqatave dhe zhvillimin e ndërmarrjeve sociale.

Gjatë këtij edicioni, në pjesën e dytë të tij u mbajt edhe konferenca "Imagjino dhe frymëzo" - E ardhmja e ndërmarrjeve sociale në Shkodër dhe perspektiva e zhvillimit në kuadër të programimit evropian dhe ndikimi i Strategjisë së Rajonit Adriatik-Ionian - EUSAIR, i cili u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak – Bashkia Shkodër, ora 14.45.

Në këtë konferencë ishin të ftuar z. Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv i AMSHC-së; znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë së Shkodrës; z. Vito Stigliani, Konsull Nderi i Konsullatës Italiane në Shkodër; znj. Irene Margeriti, Përfaqësuese e Forumit Kombëtar të Ndërmarrjeve Sociale si edhe përfaqësues nga Ministira e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dhe nga organizata të shoqërisë civile.

## AMSHC fillon procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 28 dhjetor 2015

Më datë 28 dhjetor 2015 Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) fillon procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile në zbatim të Ligjit Nr. 119 datë 06.11.2015 "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" më tej Këshilli.

Ky proces do të hapet me një konsultim publik i cili mbyllet me datë 11.01.2016.

Në datën 12 janar 2016 do të zhvillohet një takim i hapur pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të dhënë rekomandimet e fundit dhe për të vendosur mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve.